



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:174680  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05517156

**Ac.nr.5750/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEP trust, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson L. D., adresa: në Prishtinë, kundër të paditurve, L. A. dhe L. H. adresa: fshati ..., me objekt kontesti pagim i borxhit, vlera e kontestit 818.55€, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.612/15, të datës 27.05.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e paditëses KEP Trust, me seli në Prishtinë, **PRISHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.612/15, i datës 27.05.2021 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.612/15, të datës 27.05.2021 ka vendosur si në vijim: Ndërprehet procedura sipas padisë së paditëses KEP Trust, Dega në Prishtinë, rr.“Bajram Kelmendi” nr.16, të ushtruar në këtë gjykatë, për shkak se e paditura e dytë L. H. nga fshati ..., Komuna e Podujevës ka vdekur. Procedura e ndërprerë do të vazhdohet kur trashëgimtari, ose kujdestari i trashëgimtarit ndërmerr veprimet procedurale ose kur gjykata me propozim të palës së kundërt i fton ta bëjë këtë.

Kundër këtij aktvendimi paditësja, përmes përfaqësuesit të saj brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. I ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën e të njëjtës ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë ashtu që çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesat e paditëses është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 17.12.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurve me objekt të kontestit kthim i borxhit. Ndërgjyqësit kishin lidhur një kontratë kredie me datë 21.01.2014 në shumë prej 1,500€, në të cilin ishin paraparë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Paditësja kishte pretenduar se kredia nuk ishte kthyer sipas marrëveshjes, prandaj rasti përfundoi në gjykatë.

Të paditurit nuk kanë ushtuar përgjigje në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë ka hapur shqyrtimin kryesor, më pas duke nxjerrë aktvendimin e atakuar C.nr.612/15, të datës 27.05.2021, me të cilin e ka ndërprerë procedurën kontestimore, për shkak se e paditura e dytë L. H. ka vdekur.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë deri të vendosja si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën prezantoi përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse L. D., ndërsa për të paditurin e parë nuk prezantoi askush. Për të paditurën e dytë L. H. nga konstatimi i zyrtarit të postës thuhet se: “pala ka vdekur” konstatimi i datës 08.03.2021. Andaj, gjykata duke mos pasur kushte për të zhvilluar procedurën kontestimore dhe vendosjen sipas propozimit, në një gjendje të tillë e në kuptim të nenit 277 par.1 pika a) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore e ndërpreu procedurën.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit të Kosovës nuk mund t’i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 e lidhur me nenin 277 pika a) e LPK-së.

Deri të shkelja e dispozitave të cituara ka ardhur për arsye se gjykata e shkallës së parë ka ndërprerë procedurën kontestimore pasi i ka arritur konstatimi i fletëdorëzuesit, se pala ka vdekur. Fakti i tillë nuk mund të jetë shkak për ndërprerjen e procedurës, ngase detyrë e dorëzuesit është vetëm dorëzimi i shkresave tek adresati, kurse nëse gjykata nga ai vihet në njohuri se pala në procedurë ka ndërruar jetë, duhet të ndërmerr veprime me qëllim të verifikimit të këtij fakti, duke siguruar informacion nga autoritetet kompetente. Pra konstatimi i faktit të vdekjes me pasojnë ndërprerjen e procedurës, nuk mund të vijë vetëm nga një informacion i pa verifikuar paraprakisht. Sipas nenit 277 pika a) të LPK-së “*Procesi gjyqësor ndërpritet: kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim*”. Të njëjtën normë gjykata do të mund të aplikoj vetëm pas konfirmimit nga autoriteti kompetent se vërtet ka ndodhur fakti i vdekjes.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprjës në pajtim me dispozitat e LPK-së, së pari, meqë ka lindur dyshimi se ka vdekur e paditura e dytë, t'i drejtohet Qendrës së Regjistrimit Civil, apo komunës përkatëse, me kërkesë për verifikimin e faktit të vdekjes së saj, ashtu që pas sigurimit të certifikatës së vdekjes, apo informacionit zyrtar se ka vdekur ajo, të ndërpresë procedurën kontestimore.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (d) e LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.5750/2021, me datë 27.03.2024**

**Kryetari i kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**